



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 165, datë 18.12.2020

PËR

MIRATIMIN NË PARIM TË ZBATIMIT TË PROJEKTEVE “MONUMENTI QË ZGJON TURIZMIN-PERSQOP, PETRELË” DHE “PARKU I LIQENIT TË FARKËS NJË POL REKREATIV PËR TIRANËN”, TË FINANCUARA NGA PROGRAMI PËR ZHVILLIMIN RAJONAL SHQIPËRI, NË KUADËR TË THIRRJES “APLIKIME PËR SKEMËN E GRANTEVE NË MBËSHTETJE TË ZONAVE TË PREKURA NGA TËRMETI

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar; nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, nenit 54 shkronja “k”, nenit 55 pikat 2 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, vendimit nr. 157, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2020”, si dhe në vijim të shkresës me nr. 39696 prot., datë 11.11.2020 të Drejtorisë së Përgjithshme të Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Miratimin në parim të zbatimit të projekteve “Monumenti që zgjon turizmin-Persqop, Petrelë” dhe “Parku i liqenit të Farkës një pol rekreativ për Tiranën”, të financuara nga Programi për Zhvillimin Rajonal Shqipëri, në kuadër të thirrjes “Aplikime për skemën e granteve në mbështetje të zonave të prekura nga tërmeti”.
2. Ngarkohet kryetari i Bashkisë apo personi i autorizuar prej tij që pas njoftimit nga Autoriteti Kontraktues të vendimit për akordimin e grantit të nënshkruajë kontratën e grantit.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga detyrimi për pagesën e TVSH-së për kontratën e grantit do të mbulohen nga buxheti i vitit 2021 të Bashkisë Tiranë, në Programin e Projekteve të Zhvillimit.
4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

ROMINA KUKO